REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit Nr.8,datë 27.02.2026, me titull "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin janar 2026".

Analiza ligjore:

Duke u mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenet 9 dhe 24; Ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 868 datë 29.12.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 597"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 617 datë 22.09.2022; Udhëzimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind"; dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 6 datë 30.01.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Projekti synon përdorimin e fondeve të kushtëzuara për ndihmë ekonomike mujore deri në 6% të buxhetit vendor, për muajin janar 2026. Një total prej 20 familjeve do të përfitojnë një ndihmë totale prej 75,027 lekë, e shpërndarë si më poshtë:

· Për Bashkinë Sarandë: 19 familje me një fond total prej 69,146 lekë.
· Për Njësinë Administrative Ksamil: 1 familje me një fond prej 5,881 lekë.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Shpenzimet parashikohen në kuadër të fondit të kushtëzuar për ndihmë ekonomike, brenda kufirit të 6% të buxhetit vendor. Shuma totale prej 75,027 lekë do të shpërndahet në bazë të listave të miratuara (lista nr. 1 për Sarandën dhe lista nr. 2 për Ksamilin).

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social do të monitorojë shpërndarjen e subvencionimeve dhe do të raportojë për përdorimin e fondeve në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Ministria dhe buxheti i shtetit.

Impakti social / grupet që preken:

20 familje në gjendje të vështirë ekonomike në Bashkinë Sarandë dhe Njësinë Administrative Ksamil.

A është objekt i konsultimit publik?

Jo.

Vendosim
Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale I propozon Këshillit Bashkiak: Miratimin e projekt-vendimit Nr. 8, datë 27.02.2026, me titull "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin janar 2026".

Laureta Ceci _____ **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Anjeza Dike _____ **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Enea Vasili _____ **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit Nr.9, datë 27.02.2026, me titull "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin janar 2026".

Analiza ligjore:

Duke u mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenet 9 dhe 24; Ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike"; Vendimin e Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr.6 datë 30.01.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor"; dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë Sarandë nr. 73 datë 23.12.2024 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2025".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)
Projekti synon shpërndarjen e ndihmës ekonomike për muajin janar 2026, nga të ardhurat e bashkisë, për 57 familje në total, me një fond prej 258,834 lekë. Shpërndarja bëhet si më poshtë:

· Për Qendrën e Bashkisë Sarandë: 45 familje me 192,504 lekë.
· Për Njësinë Administrative Ksamil: 12 familje me 66,330 lekë.

Projekti përcakton edhe përjashtimin e disa familjeve nga skema, pasi ato tashmë përfitojnë nga skema 6% e bllok-ndihmës ekonomike. Njëkohësisht:

· 1 familje e re trajtohet për herë të parë në Qendrën e Bashkisë Sarandë (kryefamiljare grua në moshë pensioni pa pension).
· 1 familje e re trajtohet për herë të parë në Njësinë Administrative Ksamil (kryefamiljare grua e ve me dy fëmijë).
· 8 familje rifuten në skemë, përfshirë gra kryefamiljare pensioniste, viktima të dhunës në familje dhe raste të ekstremit të varfërisë.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Shuma totale prej 258,834 lekë parashikohet të shpenzohet nga të ardhurat e bashkisë, në përputhje me buxhetin e miratuar për vitin 2026 dhe kriteret për ndihmën ekonomike.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social do të monitorojë shpërndarjen e subvencionimeve dhe do të raportojë.

Impakti social / grupet që preken:

57 familje në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale në Bashkinë Sarandë dhe Njësinë Administrative Ksamil, duke përfshirë gra kryefamiljare, pensioniste me të ardhura të pamjaftueshme, viktima të dhunës në familje, dhe raste të ekstremit të varfërisë.

A është objekt i konsultimit publik?

Jo.

Vendosim

Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale i propozon Këshillit Bashkiak: Miratimin e projekt-vendimit projektvendimit Nr.9, datë 27.02.2026, me titull "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin janar 2026".

Laureta Ceci **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Anjeza Dike **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Enea Vasili **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit Nr.10,datë 27.02.2026, me titull "Për miratimin e kërkesës për financim për projekt-propozimin "Ofrimi i shërbimit 'Pak përtej distancës'".

Analiza ligjore:
Duke u mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 24; Ligjin nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 224 datë 09.04.2024 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror"; dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.102 datë 29.08.2025 "Për miratimin e Planit Social 2026-2028".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Projekti "Pak përtej distancës" synon fuqizimin dhe zgjerimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë Sarandë, duke përfshirë edhe Njësinë Administrative Ksamil. Fokusi kryesor është përmirësimi i cilësisë së jetesës për personat me aftësi të kufizuara (PAK), fëmijët me aftësi të kufizuara, si dhe familjarët dhe kujdestarët ligjorë të tyre.

Objektivat kryesore të projektit janë:

1. Përmirësimi i cilësisë së jetesës për personat PAK në gjithë territorin e bashkisë, duke përfshirë trajnimin e ndihmësve personalë për të ofruar asistencë më të kualifikuar.
2. Mbështetja e familjarëve dhe kujdestarëve ligjorë të personave PAK, duke fuqizuar rolin e familjes në kujdesin afatgjatë.
3. Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit lidhur me nevojat e personave PAK dhe promovimi i integrimit dhe barazisë sociale.

Projekti përfshin gjithashtu shtimin e një vakti ushqimor për fëmijët me aftësi të kufizuara që trajtohen në qendrat ditore.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Projekti ka një kosto totale prej 22,226,268 lekë dhe shtrihet në tre vjet.
Në këtë shërbim të ri do të angazhohen 4 profesionistë dhe 1 punonjës ndihmës.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social do të monitorojë zbatimin e projektit dhe do të raportojë .

Impakti social / grupet që preken:

· Personat me aftësi të kufizuara (fëmijë dhe të rritur) në Bashkinë Sarandë dhe Njësinë Administrative Ksamil.
· Familjarët dhe kujdestarët ligjorë të personave PAK.
· Komuniteti lokal, përmes rritjes së ndërgjegjësimit dhe përfshirjes sociale.

A është objekt i konsultimit publik?

Jo.

Vendosim
Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

1. I propozon Këshillit Bashkiak: Miratimin e projekt-vendimit. "Për miratimin e kërkesës për financim për projekt-propozimin "Ofrimi i shërbimit 'Pak përtej distancës'".

Laureta Ceci **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Anjeza Dike **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Enea Vasili **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i arsimit, rinisë, sporteve trashëgimisë kulturore.

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit Nr.12, datë 27.02.2026, me titull "Për miratimin e draft marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Sarandë, Shqipëri dhe Bashkisë së Pardubicës, Çeki".

Analiza ligjore:
Duke u mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9, pika 1.5, e cila i njeh bashkive të drejtën e bashkëpunimit me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe përfaqësimit në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore; si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 734, datë 09.09.2015, "Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore", pikat 9 dhe 11/c.

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Projekti synon miratimin në parim të draft marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Sarandë (Shqipëri) dhe Bashkisë së Pardubicës (Republika Çeke). Bashkëpunimi është nisur nëpërmjet Ambasadës së Shqipërisë në Çeki, me qëllim nxitjen e miqësisë dhe bashkëpunimit të ngushtë midis dy komuniteteve.

Binjakëzimi përbën një formë bashkëpunimi që synon:

· Zhvillimin e miqësisë dhe shkëmbimeve kulturore midis dy qyteteve.
· Nxitjen e bashkëpunimit në fushën e turizmit, kulturës dhe ekonomisë.
· Shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në fusha me interes të përbashkët.

Përfaqësuesit e Bashkisë Sarandë i janë përgjigjur pozitivisht ftesës së Bashkisë së Pardubicës dhe kanë ndjekur procedurat për formalizimin e këtij partneriteti.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Miratimi në parim i marrëveshjes së binjakëzimit nuk sjell detyrime financiare të menjëhershme për buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Projekteve, Turizmit dhe Integrimit Europian, në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë.

Impakti social / grupet që preken:

- Komuniteti i Bashkisë Sarandë në tërësi, përmes mundësive të reja për shkëmbime kulturore, turistike dhe ekonomike.
- Sektori i turizmit dhe kulturës, përmes promovimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit.

A është objekt i konsultimit publik?

Jo.

Vendosim

Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i arsimit, rinisë, sporteve trashëgimisë kulturore.

1. I propozon Këshillit Bashkiak: projektvendimit Nr.12, datë 27.02.2026, me titull "Për miratimin e draft marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Sarandë, Shqipëri dhe Bashkisë së Pardubicës, Çeki".

__Ermir Hoxha_____ Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)
__Zana Piro_____ sekretare e Komisionit
(emri, mbiemri, firma)